



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave dhe Transfereve
Ministarstvo za Finacije i Transfere / Ministry of Finance and Transfers

Nr.
Datë: 03.04.2020

Në mbështetje të nenit 8, paragrafi 1.4, të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, të Vendimit pikës 2 të 01/19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministri i Financave dhe Transfereve merr këtë:

VENDIM

1. Aprovohet Plani Operacional për Pakon Fiskale Emergjente, sipas Shtojcës së këtij Vendimi.
2. Obligohen të gjitha institucionet dhe njësitë përkatëse të propozojnë vendimet shtesë dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Besnik Bislimi

**Ministër i Financave dhe
Transfereve**

Vendimi i dërgohet:

- MEPTINIS-it
- ATK-së; dhe
- Arkivit të Ministrisë;

PLANI OPERACIONAL PËR PAKON FISKALE EMERGJENTE

Masa 1 - Pagesa e dyfishtë e vlerës së skemës sociale për të gjithë përfituesit të skemave sociale për muajin Prill dhe Maj, masë kjo në vlerë deri në shtatë milion dhe gjashtëqind e pesëdhjetë mijë (7,650,000.00 €) euro, përfshirë këtu edhe pagesën e realizuar për muajin Mars.

1. Për këtë masë, përfituesit nuk kanë nevojë të aplikojnë, kjo realizohet me automatizem në bazë të listave ekzistuese të përfituesve të këtyre skemave
2. Për realizimin e kësaj mase, Ministri i Financave dhe Transfereve nxjerr vendim ku përcaktohet që kjo shumë është paradhënie dhe që do të trajtohet më vonë, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Divizioni i Ndhimave Sociale në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, ngarkojnë listën e skemave që përfitojnë nga kjo masë si dhe listën e përfituesve të kësaj mase, deri më 18.04.2020. Thesari bën alokimin e parakohshëm, si dhe ekzekuton pagesat në bazë të listave të muajit Mars 2020.

Masa 2 - Pagesa shtesë në vlerë prej tridhjetë (30 €) euro në muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesë mujore në vlerë më të ultë se njëqind (100 €) euro, për muajin Prill, Maj dhe Qershor, me kusht që të jenë përfitues vetëm të një skeme; si dhe rikthim në listat e përfituesve për përfituesit që për shkak të mos-paraqitjes apo mos-vlerësimit në periudhën Janar - Mars 2020, nuk u janë rinovuar të drejtat e tyre. Kjo masë është në vlerë deri në trembëdhjetë milion (13,000,000.00 €) milion euro;

a) Pagesa shtesë

1. Për këtë masë, përfituesit nuk kanë nevojë të aplikojnë, kjo realizohet me automatizem në bazë të listave ekzistuese të përfituesve të këtyre skemave
2. Për realizimin e kësaj mase, Ministri i Financave dhe Transfereve nxjerr vendim ku përcaktohet që kjo shumë është paradhënie dhe që do të trajtohet më vonë, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Departamenti i Pensioneve dhe Divizioni i Ndhimave Sociale në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, sigurojnë listën e skemave që përfitojnë nga kjo masë si dhe listën e përfituesve të kësaj mase, deri më 15.04.2020.
4. Listës ekzistuese të përfituesve mbi shumën e përfitimit bazë iu shtohet vlera sipas kësaj mase dhe paguhet njëherazi, së bashku me pagesën mujore.
5. Thesari bën alokimin e parakohshëm si dhe ekzekuton pagesat.
6. Ky mekanizëm përdoret për 3 muajt derisa zgjat ekzekutimi i kësaj mase

b) Rikthimi në listë

1. Për realizimin e kësaj mase, Ministri i Financave dhe Transfereve nxjerr vendim të veçantë për rikthim të përkohshëm në listat e përfituesve, për përfituesit që për

shkak të mos-paraqitjes apo mos-vlerësimit në periudhën Janar – Mars 2020, nuk u janë rinovuar të drejtat e tyre;

2. Departamenti i Pensioneve dhe Divizioni i Ndihmave Sociale në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, sigurojnë listën e përfituesve që rikthehen, duke i bërë pjesë e listës së përfituesve të rregullt, deri më 15.04.2020
3. Kategoria që përfitojnë nga kjo masë, marrin pagesën e rregullt mujore të skemës përkatëse si dhe shtesën për 30 eurove, nëse i plotësojnë kushtet. Kjo masë nuk paragjykon në statusin e tyre pensionale dhe rinovimin e të drejtave, si dhe nuk zbatohet retroaktivisht;
4. Thesari bën alokimin e parakohshëm si dhe ekzekuton pagesat.
5. Ky mekanizëm përdoret për 3 muajt derisa zgjat ekzekutimi i kësaj mase

Masa 3 - Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që janë në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, si në vijim:

- Me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë, shoqëria tregtare do të interpretohet në kuptim të gjerë, duke përfshirë të gjithë punëdhënësit (siç mund të jenë organizatat jo qeveritare, bashkësitë fetare dhe entitete të ngjashme) që plotësojnë kriteret e përcaktuara.

(a) Mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve në vlerë prej njëqind e shtatëdhjetë (170 €) euro, për muajin Prill dhe Maj, masë kjo deri në dyzet e një milion (41,000,000.00 €) euro;

1. Kjo masë vlen për pagat e muajit Mars dhe Prill por ekzekutimi i pagesës bëhet gjatë periudhës Prill dhe Maj
2. Për të përfituar nga kjo masë duhet të plotësohen kriteret, si në vijim
 - 2.1. Punëdhënësi, përmes sistemit elektronik EDI, duhet të plotësojë dhe ngarkojë formularin dhe listën e dizajnuar nga ATK, më së largu deri më 15 Maj 2020;
 - 2.2. Punëdhënësi duhet të dëshmojë që veprimtaria e tij është ndikuar negativisht direkt apo indirekt nga situata e emergjencës shëndetësore me vendimet e Qeverisë së Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit COVID19, qoftë duke dëshmuar që vepron me njërin nga kodet e veprimtarive në aneksin A të cilave u është ndërperë puna me urdhëresë të MEPTINIS, duke deklaruar se si kanë ndikuar vendimet e Qeverisë në rënien e të hyrave të tyre, duke dëshmuar vështirësitë financiare përmes librit të arkës, bilancit bankarë dhe dëshmi të tjera të ngjajshme;
 - 2.3. I punësuar mund të përfitojë vetëm nëse i njëjti, është i deklaruar si primar në listë pagesën mujore të punëdhënësit, për periudhën shkurt, 2020;

- 2.4. I punësuari, duhet të posedojë llogari bankare valide në një nga bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
3. Kjo pagë për qëllime të tatimit do të konsiderohet si pagë primare;
 4. Kërkesat e dërguara nga punëdhënësit, do të shqyrtohen nga Komisioni i i përbashkët, i themeluar nga ATK dhe MEPTINIS, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës;
 5. Lista e të punësuarve të cilëve ju është aprovuar kërkesa për të përfituar nga kjo pikë, do të dërgohet nga Komisioni në Thesar;
 6. Thesari duhet të sigurohet që i punësuari mund të përfitojë vetëm një herë brenda një skeme një periudhe mujore.
 7. Në rast se punëdhënësi ka ekzekutuar pagat e muajit Mars 2020, në tërësi edhe pse në vështirësi financiare, pjesa e pagës prej 170 euro për punëtorët do të kreditohet në llogarinë e punëdhënësit, si rimbursim i shpenzimeve, bazuar në regjistrat e deklaruar në ATK dhe verifikimeve shtesë që mund të mbështesin këtë deklaram. Në këtë rast pastaj paga e muajit Prill kreditohet në llogarinë e punëmarrësit.
 8. ATK do të publikoj udhëzime shtesë me detajet se si bëhet dorëzimi i aplikacionit, plotësimi i formularit dhe dokumentet shtesë;
 9. Mjetet në Masën 3a buxhetohen në MEPTINIS, në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve.

(b) Subvencioni i qirasë deri në pesëdhjetë (50%) të vlerës së qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për muajin Prill dhe Maj, masë kjo në vlerë deri në dymbëdhjetë milion (12,000,000. 00€) euro; dhe

1. Për qëllime të vlerësimit të kritereve për këtë masë, ndërmarrjet klasifikohen në madhësi sipas numrit të punëtorëve;
2. Për të përfituar nga kjo masë duhet të plotësohen kriteret si në vijim:
 - 2.1. Qiramarrësi, përmes sistemit elektronik EDI, duhet të plotësojë dhe ngarkojë formularin dhe listën e dizajnuar nga ATK, më së largu deri më 15 Maj 2020;
 - 2.2. Qiramarrësi duhet të ngarkojë kontratën e qirasë në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, e cila duhet të jetë e lidhur para datës 1 Mars 2020;
 - 2.3. Qiramarrësi duhet të dëshmojë që veprimtaria e tij është ndikuar negativisht nga situata emergjente direkt apo indirekt me vendimet e Qeverisë rreth gjendjes së emergjencës shëndetësore, (ngajshëm si dëshmitë në masën 3 pika b sipër) i cili më pas do të përfitojë subvencionim deri në 50% për pagesën e qirasë;
 - 2.4. Qiradhënësi duhet të posedojë llogari bankare në një nga bankat komerciale të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.

3. Pagesa e subvencionimit të qirasë do t'i paguhet në llogarinë bankare të qiradhënësit për të dy muajt;
4. Nga kjo masë nuk mund të përfitojnë qiramarrësit të cilët kanë parapaguar qiranë vjetore, vetëm ata që e kanë obligimin e qirasë të papaguar për dy muaj që nga fillimi i pandemisë.
5. Kërkesat e dërguara nga qiramarrësit, do të shqyrtohen nga Komisioni i përbashkët i themeluar nga ATK dhe MEPTINIS, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës;
6. Lista e qiradhënësve të cilëve ju është aprovuar kërkesa për të përfituar nga kjo pikë, do të dërgohet nga komisioni në Thesar;
7. Thesari në konsultim me ATK duhet të sigurohet që të mbajë tatimin në burim prej nëntë përqind (9%), në momentin e pagesës së këtij subvencioni.
8. Mjetet në Masën 3b buxhetohen në MEPTINIS, në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve.

(c) Mbulimi i vlerës së kontributeve pensionale për pagat lidhur me masat e parapara me këtë vendim për muajin Prill dhe Maj, deri në vlerë prej tetë milion (8,000,000.00 €) euro;

1. Personave të cilët përfitojnë nga pika a) e kësaj mase do të ju paguhet kontributet pensionale në emër të punëdhënësit dhe të punësuarit dhe obligimi tatimor me qëllim që në fund, i punësuarit të marrë pagën neto prej 170 euro.
2. Personave të cilët përfitojnë paga nga masa 14 e këtij vendimi do të ju paguhet kontributet pensionale në emër të punëdhënësit dhe të punësuarit me qëllim që në fund, i punësuarit të marrë pagën neto prej 130 euro që është caktuar me këtë vendim.
3. Mjetet e parapara në Masën 3c buxhetohen në MEPTINIS, në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve.

Masa 4 - Sigurimi i huadhënies pa interes për ndërmarrjet publike që kanë vështirësi financiare për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, me qëllim të sigurimit të likuiditetit të përkohshëm të tyre, me kthim deri më 31.12.2020, në vlerë deri në njëzetë milion (20,000,000.00 €) euro.

1. Nga kjo masë mund të përfitojnë të gjitha ndërmarrjet publike që kanë vështirësi financiare për shkak të pamundësisë apo shtyrjes së afatit të inkasimit, me kusht që kjo të shkaktojë probleme në likuiditetin e tyre.
2. Ndërmarrjet publike që plotësojnë kushtin për të përfituar nga kjo masë, duhet të aplikojnë në Ministrinë e Financave dhe Transfereve më së largu deri më 15 Maj 2020, ku së bashku me kërkesën duhet të paraqesin dëshmitë përkatëse (raportet financiare, deklaratat dhe të gjitha evidencat tjera që dëshmojnë vështirësinë financiare të shkaktuar për shkak të mos-inkasimit). Po ashtu, në kërkesë duhet të ceket edhe shuma e kërkuar për huadhënie.

3. Ministria e Financave dhe Transfereve do të themelojë një grup punues të veçantë për shqyrtimin e kërkesave të pranuar. Në këtë fazë, ky grup punues mund të kërkojë nga ndërmarrjet publike që kanë aplikuar informata shtesë lidhur me kërkesën e tyre. Të gjitha kërkesat do të shqyrtohen deri në 15 ditë (pune) nga pranimi
4. Pas përfundimit të shqyrtimit të kërkesave, Grupi Punues do t'i japë rekomandim Ministrit të Financave dhe Transfereve lidhur me kërkesat, dhe këto kërkesa do të konkretizohen me Vendim të Ministrit.
5. Konform vendimit të Ministrit të Financave dhe Transfereve, ndërmarrjet publike do të nënshkruajnë marrëveshje me ministrinë, ku do të përcaktohet shuma e huasë, afati i kthimit dhe të drejtat dhe detyrimet e tjera. Marrëveshja po ashtu njeh te drejtën e vendosjes se pengut apo te drejtave mbi pasuritë e ndërmarrjes publike.

Masa 5 - Sigurimi mbështetjes shtesë financiare për Komunitet e Republikës së Kosovës që janë ndikuar në përballje me pandeminë, në rast nevojë për shkak të zgjatjes eventuale të situatës së emergjencës së shëndetit publik, në vlerë deri në dhjetë milion (10,000,000.00 €) euro.

1. Kriter për ndarjen e kësaj shume merret numri i banorëve në komuna, ndërkaq komunitet të cilat janë prekur në mënyre direkte nga pandemia mund të kenë një diskriminim pozitiv në alokim të kësaj shume.
2. Komunitet duhet të dëshmojnë shpenzimet e bëra për shkak të gjendjes së emergjencës shëndetësore, duke përdorur kodin e projektit 00099 (shpenzime për COVID-19).
3. Mjetet buxhetore në kuadër të kësaj mase, buxhetohen tek nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve e Rezervës dhe me vendim të Qeverisë, mjetet iu transferohen komunave, duke u bazuar në kriteret e përmendura në pikat 1 dhe 2 të kësaj mase.

Masa 6 - Sigurimi i shtesës mbi pagë në vlerë prej treqind (300 €) euro për punëtorët në terren dhe që janë të ekspozuar drejtpërdrejtë rrezikut të infektimit në punën e tyre (jo i gjithë stafi i institucionit): Stafi mjekësor (mjekët dhe infermierët), policët e Policisë së Kosovës, zyrtarët (gardianet) e Shërbimit Korrektues, zyrtarët (zjarrfikësit) e Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave, personeli (ushtarët) i FSK-së, punëtorët që punojnë në Karantinë - Qendra e Studentëve të Prishtinës, zyrtarët (inspektorët) e Inspektoratit të Punës, zyrtarët (inspektorët) e Administratës Tatimore të Kosovës, Zyrtarët (doganierët) e Doganës së Kosovës, zyrtarët (inspektorët) e Inspektoratit të Tregut, zyrtarët (inspektorët) e inspektorateve përkatëse komunale, zyrtarët e Inspektorati të Mjekësisë së Punës, për muajin Prill dhe Maj deri në vlerë prej pesëmbëdhjetë milion (15,000,000.00 €) euro.

1. Jo i gjithë stafi i institucioneve të listuara në këtë masë do të përfitojnë nga kjo shtesë prej 300 euro (bruto), meqë ajo është e kufizuar në dy kushte: 1) puna në terren dhe 2) ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj rrezikut të infektimit për shkak të

punës së bërë. Stafi i cili nuk i përmbush këto kushte (stafi administrativ, stafi i liruar, stafi në pushim dhe kategoritë e ngjashme) nuk mund të përfitojë nga kjo masë.

2. Të gjitha organizatat buxhetore do të hartojnë listat e zyrtarëve (të cilët kanë punuar gjatë muajit Mars) që përfitojnë nga kjo masë dhe do t'i dërgojnë Ministrisë së Financave dhe Transfereve deri më 15.04.2020, së bashku me evidencat dhe dëshmitë që ky staf i përmbush kriteret e përcaktuara. Po ashtu, organizatat buxhetore do të konfirmojnë me letër të veçantë përmes ZKA-së dhe ZKF-së që stafi i listuar i përmbush plotësisht kriteret e kësaj mase. Ky verifikim mbetet në përgjegjësinë e plotë të organizatës buxhetore.
3. Ministria e Financave dhe Transfereve ruan të drejtën për të kryer verifikime para ose pas (ex ante /ex post) ngjarjes lidhur me plotësimin e kushteve të Vendimit. Në çfarëdo rasti apo në çfarëdo kohe që konstatohet se organizata buxhetore ka përfshirë në listë përfituesë që nuk plotësojnë kriteret e vendimit, Ministria e Financave dhe Transfereve do ta inicioj rastin në organet kompetente të rendit, për keqpërdorim të detyrës zyrtare – e dënueshme sipas legjislacionit penal në fuqi.
4. Listat e pranura nga organizatat buxhetore i përcillen Ministrit të Financave dhe Transfereve për aprovim, deri më datë 20.04.2020.
5. Pas aprovimit të listës nga Ministri, përmes sistemit të pagave Thesari bën ekzekutimin e këtyre shtesave në kuadër të pagave për muajin Prill.
6. Procedura e paraparë sipas këtyre kriterëve, do të përsëritet për muajin Maj (duke dërguar listen e punëtorëve që kanë punuar gjatë muajit Prill), kjo më së largu deri më 15 Maj 2020.
7. Thesari bën alokimin e parakohshëm për të ekzekutuar pagesat të parapara me Masën 6.

Masa 7 - Pagesë shtesë në vlerë prej njëqind (100 €) euro për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave dhe barnatoreve për muajin Prill dhe Maj, në vlerë deri në tre milion (3,000,000.00 €) euro.

1. Kjo masë vlen për pagat e muajit Mars dhe Prill por ekzekutimi i pagesës bëhet gjatë periudhës Prill dhe Maj
2. Për të përfituar nga kjo masë duhet të plotësohen kriteret si në vijim:
 - 2.1. Jo të gjithë punëtorët e dyqaneve, furrave dhe barnatoreve do të përfitojnë nga kjo shtesë, meqë ajo është e kufizuar në kushtin që punëtori të ketë kontakt të drejtpërdrejt me konsumatorin gjatë punës së bërë. Punëtorët të cilët nuk e përmbushin këtë kusht nuk mund të përfitojnë nga kjo masë.
 - 2.2. Punëdhënësit të cilët ushtrojnë veprimtaritë si: dyqanet ushqimore, furrat dhe barnatoret, për punëtorët sipas pikës së lartshënuar, do të ju aprovohet kërkesa automatikisht për kompensim prej 100 euro (bruto) për të punësuarit e deklaruar në listë pagesat mujore në ato veprimtari, për periudhën mars dhe prill 2020;

- 2.3. Secili i punësuar, në mënyrë që të përfitojë nga kjo pikë, duhet të posedojë llogari bankare në një nga bankat e licencuara në Republikën e Kosovës;
- 2.4. Punëdhënësi duhet të dërgoj listën e punëtorëve (duke cekur edhe pozitën) të cilët kanë punuar gjatë muajit Mars dhe Prill në veprimtaritë si: dyqanet ushqimore, furrat dhe barnatore, tek MEPTINIS së bashku me të dhënat e llogarisë bankare të secilit punëtor dhe dëshmitë e deklarimit në ATK të këtyre punëtorëve për muajin Shkurt.
3. ATK ruan të drejtën për të kryer verifikime para ose pas (ex ante /ex post) ngjarjes lidhur me plotësimin e kushteve të Vendimit. Në çfarëdo rasti apo në çfarëdo kohe që konstatohet se punëdhënësi ka përfshirë në listë përfituesë që nuk plotësojnë kriteret e vendimit, ATK do ta inicoj rastin e përfitimit të pabazuar në organet kompetente të rendit, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Mjetet sipas Masës 7 buxhetohen tek MEPTINIS në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve.

Masa 8 - Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej njëqind e tridhjetë (130 €) euro për qytetarët që humbin vendin e tyre të punës për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, për muajin Prill, Maj dhe Qershor, në vlerë deri në katër milion (4,000,000.00 €) euro.

1. Për të përfituar nga kjo masë duhet të plotësohen kriteret si në vijim:
 - 1.1. Ish i punësuar i të jetë larguar nga puna si rezultat i rënies së aktivitetit të ndërmarrjes për shkak të situatës së pandemisë (dëshmohet me dokumentacion); arsytet tjera të largimit nuk mbulohen nga kjo masë;
 - 1.2. Ish Punëdhënësi, përmes sistemit elektronik EDI, duhet të plotësojë dhe ngarkojë formularin dhe listën e dizajnuar nga ATK, më së largu deri më 15 Maj 2020;
 - 1.3. Ish i punësuar duhet të jetë pjesë e listës së pagave të dorëzuar nga punëdhënësi në periudhën Shkurt 2020;
 - 1.4. Ish i punësuar, duhet të posedojë llogari bankare valide në një nga bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
2. Kërkesat e dërguara nga punëdhënësit do të shqyrtohen nga Komisioni i themeluar nga ATK në bashkëpunim me MEPTINIS (Agjencia e Punësimit), në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës;
3. Kjo pagë për qëllime të tatimit do të konsiderohet si pagë primare;
4. Thesari duhet të sigurohet që ish i punësuar mund të përfitojë vetëm një herë brenda një periudhe mujore në këtë skemë;
5. Përfituesit nuk mund të jenë njëkohësisht edhe përfitues të skemave tjera sipas vendimit të marrë në mbledhjen e 19-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës më 30 Mars 2020;
6. Kjo masë të buxhetohet dhe realizohet përmes divizionit përgjegjës për skemat/ndihmat sociale (divizioni i mirëqenies sociale)

7. Lista e të ish-punësuarve (tash pjesë e asistencës sociale) që evidentohen në bazë të pikës 1, i dërgohet Thesarit (MFT) nga ana e ATK-së dhe Divizionit për ndihma sociale për procedim të mjeteve.

Masa 9 - Mbështetja e iniciativave dhe projekteve që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, që janë goditur më rëndë nga situata e emergjencës së shëndetit publik, në vlerë deri në dy milion (2,000,000.00 €) euro.

1. Kjo masë do të realizohet nga Zyra e Kryeministrit – Zyra për Komunitete, në konsultim me komunat dhe Kryqin e Kuq. Kryqi i Kuq ka vullnetin dhe kapacitetin për të bashkëpunuar në realizimin e kësaj mase.
2. Marrë parasysh gjendjen dhe situatën e rënduar ekonomike të komuniteteve Rom, Ashkalinj dhe Egjiptian, kjo masë do të ketë në fokus të veçantë këto komunitete, por pa përfshirë edhe komunitetet tjera jo shumicë.
3. Të gjitha organizatat të cilët kanë programe dhe projekte për adresimin e kësaj mase, duhet të aplikojnë me programe dhe projekte konkrete në Zyrën e Kryeministrit – Zyra për Komunitete deri më 15.05.2020.
4. Zyra e Kryeministrit - Zyra për Komunitete do të shqyrtojë kërkesat dhe do të financojë projektet dhe programet konkrete, më së largu deri më 25.05.2020.

Masa 10 - Sigurimi i likuiditetit financiar për:

(a) Mikro-ndërmarrjet dhe të vetë-punësuarit nëpërmjet programeve të caktuara të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë, në shumën deri në dhjetë mijë (10,000 €) euro për periudhën 24 muajsh, në vlerë deri në pesëmbëdhjetë milionë (15,000,000.00 €) euro.

1. Për qëllim të kësaj mase, Mikro-ndërmarrje nënkupton shoqërinë tregtare e cila ka deri në 10 të punësuar aktual të dëshmuar sipas legjislacionit në fuqi, kurse të vetë-punësuarit janë persona të cilët kanë biznesin e tyre personal dhe e kanë punësuar vetëm veten në atë biznes;
2. Për të përfituar nga kjo masë, këto shoqëri tregtare duhet të aplikojnë për financim nga bankat komerciale të Republikës së Kosovës, deri në 10 mijë euro me afat të maturitetit deri në 24 muaj;
3. Në rast të aprovimit të financimit, Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë do të ofrojë garanci deri në 50% të shumës së kredituar, kurse Qeveria e Republikës së Kosovës do të mbulojë garancinë shtesë deri në 30% të shumës së kredituar (në total 80%), mbi shumën e garantuar nga FKGK.
4. Për këtë kategori do të subvencionohen 50% normat e interesit,

(b) Shoqëritë Tregtare/Kompanitë të autorizuara që ofrojnë shërbime bazike (të ngjashme me ato të ndërmarrjeve publike) me kthim deri më 31.12.2020, në kudër të vlerës së përcaktuar në 1.4. të këtij vendimi.

1. Nga kjo masë mund të përfitojnë të gjitha shoqëritë tregtare që janë të autorizuar të ofrojnë shërbime bazike (të ngjashme me ato të ndërmarrjeve publike) që kanë vështirësi financiare për shkak të pamundësisë apo shtyrjes së afatit të inkasimit, me kusht që kjo të shkaktojë probleme në likuiditetin e tyre.
2. Për të përfituar nga kjo masë, shoqëritë tregtare duhet të aplikojnë për financim nga bankat komerciale të Republikës së Kosovës, me afat kthimi deri në 31.12.2020.
3. Në rast të aprovimit të financimit, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore do të ofrojë garanci deri në 50% të shumës së kredituar, kurse Qeveria e Republikës së Kosovës do të mbulojë garancinë shtesë deri në 30% të shumës së kredituar mbi shumën e garantuar nga FKGK.
4. Për këto ndërmarrje do të subvencionohen edhe normat e interesit, pra do të jenë kredi me interes 0.

Lidhur me Masën 10, MFT dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore do të nënshkruajnë një marrëveshje të mirëkuptimit, ku do të detajohen modalitetet e zbatimit të kësaj mase, përmes hapjes së një dritareje të veçantë nga ana e FKGK për realizimin e kësaj mase.

Masa 11 - Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për rritje të prodhimit bujqësor, në vlerë prej pesë milion (5,000,000.00 €) euro.

1. Lidhur me këtë masë, MBPZHR do të identifikojë nën-sektorët më të rëndësishëm të dëmtuar dhe më urgjent të prodhimit bujqësor nga kriza e pandemisë, dhe do të përkrahen me qëllim të ringjalljes së aktivitetit ekonomik bujqësor.
2. MBPZHR do të udhëheq këtë proces në mënyrë transparente dhe në bazë të kriterit të mësipërm do të ndahen mjetet financiare.

Masa 12 - Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për evitimin e situatës së krijuar nga situata e emergjencës së shëndetit publik në aktivitetet sportive dhe kulturore, në vlerë prej pesë milion (5,000,000.00 €) euro.

1. Lidhur me këtë masë, MKRS do të identifikojë aktivitetet sportive dhe kulturore më të rëndësishëm të prekur nga kriza e pandemisë, dhe do të përkrahen me qëllim të ringjalljes së aktiviteteve kulturore dhe sportive.
2. MKRS do të udhëheq këtë proces në mënyrë transparente dhe në bazë të kriterit të mësipërm do të ndahen mjetet financiare.

Masa 13. Mbështetje për eksportuesit në Republikën e Kosovës pas përfundimit të situatës së emergjencës së shëndetit publik, vlerë deri në dhjetë milion (10,000,000.00 €) euro.

1. Lidhur me këtë masë, do të identifikohen aktivitetet ekonomike më të rëndësishme të eksportit dhe mbi këto kritere MEPTINIS, në konsultim me MFT, KIESA, ATK, Dogana dhe odat ekonomike do të udhëheq procesin e ofrimit të përkrahjes për eksportuesit.

Masa 14 - Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune së paku një (1) vjeçare gjatë periudhës së situatës së emergjencës së shëndetit publik, nga njëqind e tridhjetë (130€) euro për dy muajt pasues pas regjistrimit, në vlerë deri në gjashtë milion (6,000,000.00 €) euro.

1. Për të përfituar nga kjo masë duhet të plotësohen kriteret si në vijim:
 - 1.1. Punëdhënësi dhe i punësuarit duhet të kenë të lidhur kontratë punësimi për një periudhë jo më të shkurtër se një (1) vit;
 - 1.2. Punëdhënësi, përmes sistemit elektronik EDI, duhet të plotësojë dhe ngarkojë formularin dhe listën e dizajnuar nga ATK, më së largu deri më 15 Maj 2020;
 - 1.3. Kontrata e punësimit duhet të jetë e nënshkruar pas datës zyrtare të fillimit të pandemisë në Kosovë;
 - 1.4. Punëdhënësi duhet të deklarojë të punësuarin në listë pagesën mujore nga fillimi i kontratës së punësimit;
 - 1.5. I punësuarit, duhet të posedojë llogari bankare valide në një nga bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.
2. Personat të cilët përfitojnë nga kjo masë do të ju paguhen kontributet pensionale në emër të punëdhënësit dhe të punësuarit dhe obligimi tatimor, me qëllim që në fund i punësuarit të marrë pagën neto prej 130 euro.
3. Në rastet kur kontrata shkëputet në mënyrë arbitrare e pa ndonjë arsye valide, punëdhënësi ose punëmarrësi është i obliguar ti kthejë këto mjete, varësisht nga vlerësimi i Komisionit.
4. Shkëputet para periudhës një (1) vjeçare, punëdhënësi obligohet të kthejë shumën e paguar për të punësuarin nga Qeveria, për punën e përfituar nga punëdhënësi. Për këtë vlerë, ATK autorizohet që ta përlllogaris si detyrim punëdhënësit në librat tatimor.
5. Mjetet nga kjo masë buxhetohen tek MEPTINIS, në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve.

Masa 15 - Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej njëqind e tridhjetë (130 €) euro për qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent, që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Kosovës, për muajin Prill, Maj dhe Qershor, në vlerë deri në tre milion (3,000,000.00 €) euro.

1. Nga kjo masë përfitojnë familjet të cilat nuk kanë asnjë të punësuar (sektor publik dhe privat) dhe nuk pranojnë asnjë pagesë të rregullt mujore nga buxheti i Republikës së Kosovës (pension apo asistencë tjetër sociale) dhe që janë banor rezident të Kosovës;
2. Shuma prej 130 Euro ndahet për një familje, për periudhën Prill – Qershor 2020, në bazë të verifikimeve paraprake. Verifikimi bëhet çdo muaj, ndërsa aplikimi vetëm njëherë. Një përfaqësues i familjes deklarohet si përfitues i skemës;
3. Me qëllim të përfitimit nga kjo skemë, nga përfaqësuesi i familjes duhet të bëhet kërkesa me shkrim që duhet të përmbajë të dhënat e përfaqësuesit/përfituesit, një deklaram që asnjë nga anëtarët e familjes nuk ka të hyra mujore dhe nuk përfiton nga skemat sociale dhe pensionale dhe dëshmia e regjistrimit si i papunë në Agjencinë/Entin e Punësimit shërben si dëshmi në mbështetje të aplikacionit por nuk është e domosdoshme në këtë kohë. Megjithatë, aplikimi në entin e punësimit mund të bëhet edhe në mënyrë elektronike, përmes metodave me të cilat do t'i njoftoj Agjencia e Punësimit përmes kanaleve të saj të komunikimit. Kërkesat duhet të bëhen më së largu deri më 15 Maj 2020.
4. Ministria e Financave dhe Transfereve do të hartojë një aplikacion për kërkesë, në të cilën do të shënohen të dhënat e nevojshme familjare dhe autorizimi i nevojshëm për përpunim të të dhënave personale, me qëllim të zbatimit të kësaj mase.
5. Kërkesat shqyrtohen nga Divizioni për Ndhim Socialë në kuder të Ministrisë së Financave dhe Transfereve dhe përgatit listën për verifikim. Marrja e informacionit dhe verifikimi i anëtarëve të familjes lidhur me kushtet e tyre, për të vërtetuar nëse i plotësojnë kushtet për të përfituar nga kjo masë bëhet përmes ARC-së në mënyrë elektronike (certifikatë familjare ose trungu familjar).
6. Të dhënat për të hyrat eventuale mujore për secilën familje verifikohen nga ATK, IT Administratori i data bazës së të dhënave të skemave sociale dhe pensionale (Departamenti i Pensioneve dhe Departamenti për Mirëqenie/Sociale) dhe Thesari/Divizioni i Pagave (aktivitet i përbashkët me ATK).
7. Pagesat sipas kësaj skeme realizohen për muajin Prill, jo më vonë se data 5 Maj, në kuadër të programit të asistencës sociale, sipas listës së përfituesve.
8. Thesari lejon alokim të parakohshëm për zbatimin e kësaj mase.

Aneksi A Lista e kodeve të veprimtarisë të cilave u ndalohet veprimtari me urdheresën e MEPTINIS të datës 23 mars 2020.

45	45			Tregtia me shumicë dhe pakicë, si dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave
	45	45.1		Tregtia e automjeteve
	45		45.11	Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël
	45		45.19	Tregtia e automjeteve të tjera
	45	45.3		Tregtia e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve
	45		45.31	Tregtia me shumicë e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve
	45		45.32	Tregtia me pakicë e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve
	45	45.4		Tregtia, mirëmbajtja dhe riparimi i motoçikletave dhe pjesëve e aksesorëve të tyre
	45		45.4	Tregtia, mirëmbajtja dhe riparimi i motoçikletave dhe pjesëve e aksesorëve të tyre
	46		46.18	Veprimtaritë e ndërmjetësimit të specializuar për shitjen e produkteve të veçanta
	46		46.19	Veprimtaritë e ndërmjetësimit për shitjen e një shumëllojshmërie mallrash
	47	47.4		Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara
	47		47.41	Tregtia me pakicë e kompjuterëve, njësive periferike dhe softuerëve, në dyqane të specializuara
	47		47.42	Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikimit në dyqane të specializuara
	47		47.43	Tregtia me pakicë e pajisjeve audio dhe video në dyqane të specializuara
	47	47.5		Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara
	47		47.51	Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara
	47		47.52	Tregtia me pakicë e artikujve elektronikë, ngjyrave dhe xhamit, në dyqane të specializuara
	47		47.53	Tregtia me pakicë e qilimave, sixhadeve, veshjeve të mureve dhe dysHEMEVE, në dyqane të specializuara
	47		47.54	Tregtia me pakicë e pajisjeve elektroshtëpiake në dyqane të specializuara
	47		47.59	Tregtia me pakicë e mobilieve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve të tjerë shtëpiakë, në dyqane të specializuara
	47	47.6		Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara
	47		47.61	Tregtia me pakicë e librave në dyqane të specializuara
	47		47.62	Tregtia me pakicë e gazetave dhe materialit të shkrimit, në dyqane të specializuara
	47		47.63	Tregtia me pakicë e incizimeve muzikore dhe videove, në dyqane të specializuara
	47		47.64	Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara
	47		47.65	Tregtia me pakicë e lojërave dhe lodrave, në dyqane të specializuara
	47	47.7		Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara
	47		47.71	Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara
	47		47.72	Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure, në dyqane të specializuara
	47		47.76	Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farërave, plehrave artificialë, kafshëve përkdhelëse dhe ushqimi i tyre, në dyqane të specializuara
	47		47.77	Tregtia me pakicë e orëve dhe argjentarisë në dyqane të specializuara
	47		47.78	Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja, në dyqane të specializuara
	47		47.79	Tregtia me pakicë e mallrave të përdorura në dyqane
	47	47.8		Tregtia me pakicë përmes tezgave dhe tregjeve
	47		47.81	Tregtia me pakicë në tezga dhe tregje të produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit
	47		47.82	Tregtia me pakicë në tezga dhe tregje të tekstileve, veshjeve dhe këpucëve
	47		47.89	Tregtia me pakicë në tezga dhe tregje të mallrave të tjera
	47	47.9		Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje
	47		47.99	Tregtia tjetër me pakicë, jo në dyqane, tezga ose tregje
49	49			Transporti tokësor dhe transporti përmes tubacioneve
	49	49.1		Transporti hekurudhor ndërrurban i pasagjerëve

	49		49.1	Transporti hekurudhor nderurban i pasagjerëve
	49	49.2		Transporti hekurudhor i mallrave
	49		49.2	Transporti hekurudhor i mallrave
	49	49.3		Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve
	49		49.31	Transporti rrugor urban dhe ndërurban i pasagjerëve
	49		49.32	Veprimtaria i taksive
	49		49.39	Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t.
	49	49.4		Transporti rrugor i mallrave dhe shërbimet e zhvendosjes
	49		49.41	Transporti rrugor i mallrave
	49		49.42	Shërbimet e zhvendosjes
	49	49.5		Transporti përmes tubacioneve
	49		49.5	Transporti përmes tubacioneve
50	50			Transporti ujqor
	50	50.1		Transporti detar dhe bregdetar i pasagjerëve
	50		50.1	Transporti detar dhe bregdetar i pasagjerëve
	50	50.2		Transporti detar dhe bregdetar i mallrave
	50		50.2	Transporti detar dhe bregdetar i mallrave
	50	50.3		Transporti i brendshëm ujqor i pasagjerëve
	50		50.3	Transporti i brendshëm ujqor i pasagjerëve
	50	50.4		Transporti i brendshëm ujqor i mallrave
	50		50.4	Transporti i brendshëm ujqor i mallrave
51	51			Transporti ajror
	51	51.1		Transporti ajror i pasagjerëve
	51		51.1	Transporti ajror i pasagjerëve
	51	51.2		Transporti ajror i mallrave dhe transporti hapësinor
	51		51.21	Transporti ajror i mallrave
	51		51.22	Transporti hapësinor
52	52			Magazinimi dhe veprimtaritë mbështetëse për transport
	52	52.1		Magazinimi dhe ruajtja
	52		52.1	Magazinimi dhe ruajtja
	52	52.2		Aktivitetet mbështetëse për transport
	52		52.21	Veprimtaritë shërbyese të rastit për transportin tokësor
	52		52.22	Veprimtaritë shërbyese të rastit për transportin ujqor
	52		52.23	Veprimtaritë shërbyese të rastit për transportin ajror
	52		52.24	Trajtimi i transportit "cargo"
	52		52.29	Veprimtaritë e tjera mbështetëse të transportit
56	56			Veprimtaritë shërbyese të ushqimit dhe pijeve
	56	56.1		Restorantet dhe veprimtaritë shërbyese lëvizëse të ushqimit
	56		56.1	Restorantet dhe veprimtaritë shërbyese lëvizëse të ushqimit
	56		56.29	Veprimtaritë e tjera shërbyese të ushqimit
	56	56.3		Veprimtaritë shërbyese të pijeve
	56		56.3	Veprimtaritë shërbyese të pijeve
58	58			Veprimtaritë botuese
	58	58.1		Publikimi i librave, periodikëve dhe veprimtaritë e tjera të publikimit
	58		58.11	Publikimi i librave
	58		58.12	Publikimi i adresarëve dhe numrave telefonikë
	58		58.13	Publikimi i gazetave
	58		58.14	Publikimi i revistave dhe periodikëve
	58		58.19	Veprimtaritë e tjera botuese
79	79			Agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe shërbimet e rezervimeve të tjera dhe veprimtaritë lidhur me to
	79	79.1		Agjencitë e udhëtimit dhe veprimtaritë e operatorëve turistikë
	79		79.11	Veprimtaritë e agjencive të udhëtimit
	79		79.12	Veprimtaritë e operatorëve turistikë
	79	79.9		Shërbimet e tjera të rezervimit dhe veprimtaritë e lidhura me to
	79		79.9	Shërbimet e tjera të rezervimit dhe veprimtaritë e lidhura me to
	82		82.19	Fotokopjimi, përgatitja e dokumenteve dhe veprimtaritë e tjera të specializuara mbështetëse për zyrat
	82	82.2		Veprimtaritë e qendrave të thirrjeve
	82		82.2	Veprimtaritë e qendrave të thirrjeve

85	85		Arsimi
	85	85.1	Arsimi parashkollor
	85	85.1	Arsimi parashkollor
	85	85.2	Arsimi fillor (cikli i ulët i arsimit 9 vjeçar)
	85	85.2	Arsimi fillor
	85	85.3	Arsimi i mesëm
	85	85.31	Arsimi i përgjithshëm i mesëm
	85	85.32	Arsimi i mesëm teknik dhe profesional
	85	85.4	Arsimi i lartë
	85	85.41	Arsimi pas të mesmes, por jo i lartë
	85	85.42	Arsimi i lartë
	85	85.5	Arsimi tjetër
	85	85.51	Arsimi për sporte dhe rekreacion
	85	85.52	Arsimi kulturor
	85	85.53	Aktivitetet e autoshkollave
	85	85.59	Arsimi tjetër p.k.t.
	85	85.6	Veprimtaritë mbështetëse arsimore
	85	85.6	Veprimtaritë mbështetëse arsimore
87	87		Veprimtaritë e përkujdesjes në shtëpi
	87	87.1	Veprimtaritë e përkujdesjes infermerike në shtëpi
	87	87.1	Veprimtaritë e përkujdesjes infermerike në shtëpi
	87	87.2	Veprimtaritë e përkujdesjes në shtëpi për të sëmurët mendorë, të shëndetit mendor dhe abuzimit të substancave
	87	87.2	Veprimtaritë e përkujdesjes në shtëpi për të sëmurët mendorë, të shëndetit mendor dhe abuzimit të substancave
	87	87.3	Veprimtaritë në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta
	87	87.3	Veprimtaritë në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta
	87	87.9	Veprimtaritë në shtëpitë e tjera të kujdesit p.k.t.
	87	87.9	Veprimtaritë në shtëpitë e tjera të kujdesit p.k.t.
88	88		Veprimtaritë e kujdesit social pa akomodim
	88	88.1	Veprimtaritë e kujdesit social pa akomodim për të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta
	88	88.1	Veprimtaritë e kujdesit social pa akomodim për të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta
	88	88.9	Veprimtaritë e tjera të kujdesit social pa akomodim
	88	88.91	Veprimtaritë e kujdesit ditor të fëmijëve
	88	88.99	Veprimtaritë e tjera të kujdesit social pa akomodim p.k.t.
90	90		Veprimtaritë krijuese, artistike dhe argëtuese
	90	90	Veprimtaritë krijuese, artistike dhe argëtuese
	90	90.01	Shfaqjet artistike
	90	90.02	Veprimtaritë mbështetëse për shfaqje artistike
	90	90.03	Krijimtaria artistike
	90	90.04	Funksionimi i objekteve të artit
91	91		Bibliotekat, arkivat, muzetë dhe veprimtaritë e tjera kulturore
	91	91	Veprimtaritë e bibliotekave, arkivave, muzeve dhe veprimtaritë e tjera kulturore
	91	91.01	Veprimtaritë e bibliotekave dhe të arkivave
	91	91.02	Veprimtaritë e muzeve
	91	91.03	Funksionimi i vendeve dhe ndërtesave historike, si dhe i atraksioneve të ngjashme për vizitorë
	91	91.04	Kopshtet botanike dhe zoologjike, si dhe veprimtaritë e pasurive natyrore
93	93		Veprimtaritë sportive, argëtuese dhe veprimtaritë e rekreacionit
	93	93.1	Veprimtaritë sportive
	93	93.11	Funksionimi i objekteve sportive
	93	93.12	Veprimtaritë e klubeve sportive
	93	93.13	Palestra e fitnesit
	93	93.19	Veprimtaritë e tjera sportive
	93	93.2	Veprimtaritë argëtuese dhe të rekreacionit

	93		93.21	Veprimtaritë e parqeve të argëtimit dhe atyre me orientim të caktuar
	93		93.29	Veprimtaritë e tjera të argëtimit dhe rekreacionit
94	94			Aktivitetet e shoqatave dhe organizatave
	94	94.1		Veprimtaritë e shoqatave dhe organizatave ekonomike, punëdhënësve dhe shoqatave profesionale
	94		94.11	Veprimtaritë e shoqatave dhe organizatave ekonomike, punëdhënësve
	94		94.12	Veprimtaritë e shoqatave profesionale
	94	94.2		Veprimtaritë e sindikatave të të punësuarve
	94		94.2	Veprimtaritë e sindikatave të të punësuarve
	94	94.9		Veprimtaritë e organizatave të tjera
	94		94.91	Veprimtaritë e organizatave fetare
	94		94.92	Veprimtaritë e organizatave politike
	94		94.99	Veprimtaritë e organizatave të tjera p.k.t.
96	96			Veprimtaritë e tjera shërbyese
	96	96		Veprimtaritë e tjera shërbyese
	96		96.02	Sallonet e floktarisë dhe trajtimet e tjera të bukurisë
	96		96.04	Veprimtaritë e mirëmbajtjes trupore
	96		96.09	Veprimtaritë e tjera p.k.t.